



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 18 prill 2023  
Ref.nr:r RK 2155/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KIo8/23**

Parashtrues

**Sejdi Selimi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev.nr.362/21] të 14 nëntorit  
2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

**GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Sejdi Selimi, me vendbanim në Vushtri (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev.nr.362/21] e 14 nëntorit 2022 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i kontestuar) të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 14 dhjetor 2022.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

1. Më 17 janar 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
2. Më 25 janar 2023, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, me Vendimin Nr. GJR.KIo8/23, caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare raportuese dhe me Vendimin KSH.KIo8/22 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesues), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
3. Më 1 shkurt 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën datë, një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
4. Më 5 prill 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

5. Më 25 janar 2007, parashtruesi i kërkesës bashkë me paditësit e tjerë (A.G.), (B.SH.), (I.G.), (S.S.), (K.D.), (XH.G.), (N.B.), (N.J.), (A.A.), (B.S.), (V.B.), (G.A.), (I.H.), (D.H.), (R.O.) [në tekstin e mëtejme: paditësit], dorëzuan kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale), kundër të paditurit (F.K.), nëpërmjet së cilës kërkuan lirim të pronës nga i padituri(F.K.), në lagjen Ulpianë (ndërtesa A6/II-Bodrum) në Prishtinë.
6. Më 29 maj 2007, parashtruesi i kërkesës dhe paditësit plotësuan kërkesëpadinë e tyre dhe kërkuan nga Gjykata Komunale vendosjen e masës së përkohshme. Të njëjtën datë, të njëjtit dorëzuan parashtrësë për precizimin e padisë dhe saktësimin e vlerës së kontestit të padisë në shumën prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) euro.
7. Më 20 shtator 2012, Gjykata Komunale nëpërmjet Aktgjykimit [C.nr. 129/2007], refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe të paditësve.

8. Më 16 nëntor 2012, parashtruesi i kërkesës dhe paditësit dorëzuan ankesë në Gjykatën e Qarkut, kundër Aktgjykimit të 20 shtatorit 2012 të Gjykatës Komunale, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
9. Më 30 qershor 2015, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktvendimit [Ca.nr.1145/2013], miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të paditësve, prishi Aktgjykimin e 20 shtatorit 2012 të Gjykatës Komunale, duke kthyer çështjen në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.
10. Më 25 prill 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), nëpërmjet Aktgjykimit [C.nr.2071/2015], refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe paditësve.
11. Më 2 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës dhe paditësit paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
12. Më 15 dhjetor 2020, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktgjykimit [Ac.nr. 3949/18], refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të paditësve dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
13. Më 2 mars 2021, parashtruesi i kërkesës dhe paditësit dorëzuan revizion në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
14. Më 14 nëntor 2021, Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit [Rev.nr. 362/21], refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës dhe të paditësve, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
16. Parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta e kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe se nuk i kanë vlerësuar drejtë provat e administruara, dhe si pasojë konkludimet dhe qëndrimet e tyre janë të gabuara.
17. Parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta ia njohën uzurpimin të paditurit (F.K.), si të ligjshëm në kundërshtim me Kushtetutën, duke shtuar se: *“E drejta në pronë është e drejtë absolute, e garantuar me nenin 46.1 dhe askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga pronë. E drejta e kthimit të pronës apo sendit nuk parashkruhet, ndërsa pronari ka të drejtë kërkimin e sendit në çdo kohë”*.
18. Parashtruesi i kërkesës pretendon që: *“...deri te shkelja e neneve të lartcekura ka ardhur për shkak se gjykatat nuk i kanë vlerësuar drejt provat e administruara dhe për pasojë kanë nxjerrë konkluzione të gabuara dhe të pa qëndrueshme. Në bazë të LMD-së, kontrata e plotfuqishme është ligj për palët. Të gjithë paditësit i kanë prezantuar në gjykatë kontratat për blerjen e banesave bashkë me të edhe të bodrumeve. Këtë fakt gjykatat nuk e kanë vlerësuar dhe pa bazë ligjore e refuzojnë kërkesëpadinë. Gjykatat nuk u falin besimin dokumenteve valide me fuqi ligjore, siç janë kontratat por ia falin besimin uzurpatorit”*.

19. Parashtruesi i kërkesës propozon që Gjykata të deklarojë të pranueshme kërkesën, të ndryshojë Aktgjykimin e kontestuar dhe çështja të kthehet në rivendosje.

## **Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 24 [Barazia para Ligjit]**

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

#### **Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
  2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
  3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
  4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
  5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
- [...]

#### **Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]**

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

## LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

### KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Neni 7

7.1 Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

7.2 Gjykata është e autorizuar të vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe të marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

7.3 Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.

#### Neni 8

8.1 Se cilat fakte do t'i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit.

8.2 Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon ç'do provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku.

### **Shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi**

#### Neni 182

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

a) në qoftë se gjykata është përbërë jo sipas dispozitave ose në çoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari që nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore;

b) në qoftë se është vendosur për kërkesën e cila nuk bënë pjesë në juridiksionin gjyqësor;

c) në çoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet, respektivisht me vendim të gjykatës ka qenë i përjashtuar ose me rastin e dhënies se vendimit ka marrë pjesë personi i cili nuk e ka cilësinë e gjyqtarit;

d) në çoftë se gjykata sipas prapsmit të palëve gabimisht ka vendosur se është e kompetencës lëndore;

e) në çoftë se është vendosur për kërkesën sipas padisë të ngritur pas afatit të përcaktuar me ligj;

f) në çoftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është me kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata e llojit tjetër;

g) në çoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka bazuar vendimin e vetë në disponimin e palejueshëm të palëve, (neni 3 paragrafi 3 i këtij ligji);

h) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata ka nxjerr aktgjykim për shkak të pohimit, mosbindjes, mungesës, heqjes dorë nga kërkesëpadia, ose pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor;

- i) në qoftë se ndonjëri nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë;
- j) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjek procesin në gjuhën e vet, kurse për këtë arsye ankohet;
- k) në qoftë se në procedurë si paditës, ose i paditur, ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedurës apo për kryerjen e ndonjë veprimi në procedurë, në qoftë se zhvillimi i procedurës, respektivisht ushtrimi i veprimeve të veçanta në procedurë nuk është lejuar më vonë;
- l) në qoftë se është vendosur për kërkesën për të cilën vazhdon procedura apo për të cilën më parë është nxjerr aktgjykimi i formës së prerë, ose prej të cilit paditësi njëherë ka hequr dorë ose për të cilin është lidhur pajtimi gjyqësor;
- m) në qoftë se, në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore;
- n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;
- o) në qoftë se me aktgjykim është tejkaluar kërkesëpadia.

## **KREU XXII**

### **MJETET PROVUESE DHE MARRJA E PROVAVE**

#### **Dispozita të përgjithshme**

#### Neni 319

319.1 Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

319.2 Të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit. 319.3 Gjykata vendosë se cilat prova do të merren me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare.

#### Neni 322

322.1 Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës.

322.2 Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.

322.3 Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.

### **KËQYRJA NË VEND**

#### Neni 326

326.1 Këqyrja në vend ndërmerret sa herë që çmohet e nevojshme që për vërtetimin e ndonjë fakti, apo për sqarimin e ndonjë rrethane, duhet të bëhet vrojtimi i drejtpërdrejt nga gjykata e çështjes.

326.2 Marrja e provës me anë të këqyrjes së drejtpërdrejt mund të bëhet edhe me bashkëveprimin e ekspertit.

### Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113  
[Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

*[...]*

22. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”*

23. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin Rev. nr. 362/2022, të 14 nëntorit 2022 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet

juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parashihet nën 49 i Ligjit.

24. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënrregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

*“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk e mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”*

[...]

25. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43); dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih rastet e GjEDNj-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i); [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii); dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
26. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që, Aktgjykimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet: 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
27. Megjithatë, në thelb Gjykata verën se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe interpretimin e gabuar të ligjit. Në këtë kontekst, Gjykata do t’i shqyrtojë dhe analizojë këto pretendime, në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, gjykatat e rregullta dhe Gjykata Kushtetuese është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

#### **i. Vlerësimi i Gjykatës përkritazi me pretendimet e “shkallës së katërt”**



a) Parimet e përgjithshme

28. Gjykata përsërit se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e GjEDNj, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999). Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi/ja të ketë pasur gjykim të drejtë (shih rastin e GjEDNj, [Edëards kundër Mbretësisë së Bashkuar](#), nr. 13071/87; dhe rastin e Gjykatës [KI192/13](#), me parashtrues [Hatixhe Avdyli](#), Aktvendimi i 24 shkurtit 2014).
29. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e fakteve ose ligjshmërisë që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përveç nëse ato i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNj. Andaj, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt”, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Çështjet që lidhen me vlerësimin e provave dhe peshimin e tyre nga ana e gjykatave vendore, nuk janë në kompetencën e Gjykatës të rishikohen (shih rastin e GjEDNj, [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), Aktgjykim i 29 nëntorit 2016; dhe rastin e Gjykatës [KI70/11](#), me parashtrues [Faik Hima, Magbule Hima, Bestar Hima](#), Aktvendimi i 12 dhjetorit 2011).
30. Gjykata, megjithatë, thekson se jurisprudenca e GJEDNj-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNj-në (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNj, [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 25 majit 2000.).
31. Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlihet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar”, në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare”, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë “qartazi të gabuar”, në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin përkatës.
32. Gjykata rikujton se neni 31 i Kushtetutës nuk i garanton askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcakton që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e së drejtës materiale nga gjykatat e rregullta në një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. Gjykata, në fund, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund të ngrejë vetvetiu pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin e GjEDNj-së, [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; rastin e Gjykatës [KI96/21](#), parashtrues [Xhelal Zherka](#), Aktvendim i 10 shtatorit 2021).
33. Gjykata, si rregull të përgjithshëm, ka theksuar që nuk mund të vë në dyshim gjetjet e gjykatave të rregullta që kanë të bëjnë me: (i) vërtetimin e fakteve të rastit; (ii) interpretimin dhe zbatimin e ligjit; (iii) pranueshmërinë dhe vlerësimin e provave në gjykim; (iv) drejtësinë substanciale të rezultatit të një kontesti civil; apo edhe (v) fajin ose pafajësinë e të akuzuarit në procedurën penale.

34. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GjEDNj-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua edhe më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNj-në (shih rastin e GjEDNj-së, [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 25 majit 2000; rastin e Gjykatës [KI179/18](#), me parashtruesen *Belgjyzar Latifi*, Aktvendimi i 24 qershorit 2020).
35. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e Gjykatës [KI49/19](#), me parashtrues *Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “Adem Jashari”, Aktvendimi i 10 shtatorit 2019).

*b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret*

36. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk i kanë vlerësuar drejtë provat e administruara dhe dokumentet ligjore, dhe rrjedhimisht kanë marrë vendime të gabuara. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës bashkë me paditësit e tjerë, nëpërmjet padisë së ushtruar në Gjykatën Komunale, kishin kërkuar largimin e të paditurit nga paluajtshmeria (banesa) në sipërfaqe prej 56 metrash katrorë, në lagjen Ulpianë, ndërtesa A6/II-Bodrum. Sipas tyre, paluajtshmeria në fjalë ishte pronë e përbashkët e parashtruesit të kërkesës dhe e paditësve, dhe është përdorur në formë të bodrumit, e cila sipas tyre ishte uzurpuar jashtëligjshëm nga i padituri (F.K.).
37. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimin [C.nr.2071/2015] të 25 prill 2018 të Gjykata Themelore, e cila kishte refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë, duke arsyetuar, si në vijim:

*“Paditësit në rastin konkret nuk arritën që të provojnë pretendimet e tyre se ata janë pronarë të bodrumit kontestues dhe se atë e kanë shfrytëzuar në mënyrë të lirë dhe të papenguar deri në vitin 2006. Edhe përkundër dy ekspertizave të nxjerra si provë, nuk është arritur të vërtetohet fakti se pjesa kontestuese e bodrumit prej 53.88 metra katrorë, të cilën e shfrytëzon si objekt banimi tani i padituri, u takon paditësve në bashkëpronësi, respektivisht se kjo pjesë e bodrumit kontestues i takon paditësve mbi bazën e kontratave për blerjen e banesës siç pretendojnë paditësit.*

*Edhe kontratat e shitblerjes së banesave për disa nga paditësit e lartcekur nuk janë të besueshme dhe relevante për gjykatën sa i përket bodrumit kontestues ngase në ato kontrata nuk është precizuar se të njëjtit janë bashkëpronarë në bodrumin kontestues, ndërsa në kontratat në të cilat është përmendur bodrumi si objekt kontraktues nuk është precizuar sipërfaqja dhe njësia. Paditësit kërkojnë lirimin e paluajtshmërisë, duke pretenduar në të drejtën e bashkëpronësisë mbi objektin e kontestit, sipas bazës së ekzistimit të kontratave për shitblerjen e banesave. Nga shkaqet e cekura më lart nuk mund të kërkohet lirimi i patundshmërisë në bazë të lidhjes së kontratës.*

*Gjykata ekspertizës së ekspertit të ndërtimtarisë S. B. ia fali pjesërisht besimin, pasi që në pjesë të caktuara të saj lidhur me konstatimet se objekti kontestues – bodrumi, iu takonte paditësve, e njëjta nuk u bazua mbi të dhëna të dokumentuara po mbi bindjen e lirë të ekspertit. Ekspertiza nuk arriti të vërtetonte gjendjen faktike të cilën e pretendojnë paditësit, respektivisht se pjesa e bodrumit prej 53.88 metra katrorë, të cilën i padituri e shfrytëzon si banesë, ka qenë pjesë e përbashkët*

*e paditësve. Edhe nga kontratat e shitblerjes së banesës për të paditurit, mungojnë të dhënat lidhur me bodrumet të cilat i disponojnë këto banesa, pra se a është objekti kontestues pjesë e bodrumeve të ndonjërit nga paditësit individualisht.”*

38. Tutje, Gjykata i referohet Aktgjykimit [Ac.nr. 3949/18] të 15 dhjetor 2020 të Gjykatës së Apelit, e cila arsyetoi si në vijim:

*“Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k), (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.*

*Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me këtë çështje, pasi që kjo e fundit me të drejtë ka konstatuar se paditësit nuk arritën që të provojnë pretendimet e tyre para gjykatës se ata janë pronar të bodrumit kontestues, si dhe faktin tjetër se këtë bodrum e kanë shfrytëzuar në mënyrë të lirë dhe të papenguar deri në vitin 2006. Gjithashtu është i drejtë edhe konstatimi tjetër i gjykatës së shkallës së parë se edhe përkundër dy ekspertizave të nxjerra si provë, nuk është arritur të vërtetohet fakti se pjesa kontestuese e bodrumit prej 53.88 metra katrorë, të cilën e shfrytëzon si objekt banimi tani i padituri, u takon paditësve në bashkëpronësi, respektivisht se kjo pjesë e bodrumit kontestues i takon paditësve mbi bazën e kontratave për blerjen e banesës siç pretendojnë paditësit.*

*Si rrjedhojë, meqenëse gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se nga provat e administruara, ka rezultuar se paditësit nuk e kanë provuar faktin se janë shfrytëzues apo pronar të bodrumit kontestues, dorëzimin e të cilit e kërkojnë nga i padituri, përkatësisht të njëjtit përveç se nuk e kanë titullin juridik për fitimin e të drejtës së pronësisë-shfrytëzimit, të njëjtit këtë të drejtë nuk e kanë regjistruar në Regjistrin Kadastral, ashtu siç kërkohet me dispozitat ligjore të përmendura më lartë. Andaj, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se provat e dorëzuara nga paditësit nuk mund të jenë bazë e vlefshme juridike, përkatësisht nuk mund të prodhojnë efekt juridik për gjykatën, në mënyrë që të bazojë aktgjykimin e saj, për të detyruar të paditurin që t'i dorëzojë në posedim bodrumin në fjalë këtyre paditësve.”*

39. Gjykata vëren se arsyetimet e gjykatave të rregullta, përkatësisht të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, kanë argumentuar mjaftueshëm refuzimin e padisë së parashtruesit të kërkesës dhe paditësve të tjerë. Me fjalë të tjera, gjykatat e rregullta kanë vlerësuar dhe interpretuar faktet dhe provat gjatë procedurave gjyqësore; i kanë peshuar ato sipas rëndësisë së tyre; dhe kreyt në fund kanë marrë vendimet meritore. Siç është elaboruar edhe më lartë, gjykatat e rregullta gëzojnë autoritet të plotë në lidhje me vërtetimin e fakteve, interpretimin e provave dhe peshimin e tyre, dhe zbatimin e ligjeve materiale në rrethanat e rasteve konkrete. Thënë ndryshe, gjykatat e rregullta kanë të drejtë që gjatë vlerësimit, të pranojnë apo refuzojnë një provë, të marrin për bazë apo jo një ekspertizë, të trajtojnë një dokument ligjor dhe kështu me radhë. Është në diskrecionin e plotë të tyre vlerësimi dhe verifikimi i fakteve dhe provave.
40. Parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta: “...nuk ia falin besimin dokumenteve valide me fuqi ligjore, siç janë kontratat”. Si pasojë e kësaj, sipas tij,

vendimet ishin të gabuara. Gjykata vëren se arsyetimet e gjykatave të rregullta argumentojnë se pse është marrë parasysh një provë në raport me një provë tjetër, përfshirë këtu edhe kontratat, cilat prova kanë qenë vendimtare në të provuarit e fakteve, dhe si janë interpretuar dispozitat ligjore. Të gjitha këto, siç është argumentuar më lartë, janë në autoritetin e gjykatave të rregullta, të cilat, gjatë procesit gjyqësor bëjnë vlerësimin e provave dhe të fakteve, dhe zbatojnë ligjin material. Gjykata nuk ka juridiksion për të ndërhyrë në këto çështje, e as të kontestojë interpretimet e gjykatave të rregullta. Gjykata sigurohet vetëm nëse interpretimet e gjykatave të rregullta, nuk shkelin të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe Konventë, apo, nëse vendimet e këtyre të fundit nuk janë marrë në mënyrë arbitrare ose nuk janë “qartazi të paarsyeshme”. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta nuk kanë vendosur në mënyrë arbitrare, e as në mënyrë “qartazi të paarsyeshme”, dhe rrjedhimisht gjykatat e rregullta kanë ushtruar juridiksionin e tyre ligjor.

41. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës dhe paditësit e tjerë, parashtruan revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktgjykimit [Rev.nr. 362/2021] të 14 nëntorit 2022, në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, arsyetoi si në vijim:

*“Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë lidhur me refuzimin e ankesës së palës paditëse, dhe se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë është e detyruar të kujdeset sipas detyrës zyrtare, sipas nenit 215 të LPK-së.*

*Aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me dispozitat nga neni 160 i LPK-së, ngase dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar është në përputhje me të drejtën materiale, si dhe ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore, duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, po ashtu arsyet e dhëna justifikojnë vendosjen për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve, për shkak se paditësit kanë dështuar të ofrojnë prova me të cilat e provojnë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.*

*Pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nuk u pranuan si të bazuara nga ana e Gjykatës Supreme, pasi që gjykata e shkallës së parë dhe të dytë duke e vlerësuar të njëjtin pretendim të paditurës të paraqitur edhe pranë këtyre gjykatave, kanë dhënë arsyetim të plotë, të qartë dhe të njëjtat arsye janë të pranueshme edhe për Gjykatën e revizionit, pasi në rastin konkret, paditësit nuk kanë mundur të provojnë se kanë të drejta pronësore apo të drejta të posedimit apo shfrytëzimit në raport me kërkesën për dorëzimin e paluajtshmërisë kontestuese, ndonëse për dorëzimin e sendit paditësit është dashur të provojnë bazën juridike mbi të cilën e kërkojnë dorëzimin e paluajtshmërisë kontestuese nga i padituri.”*

42. Gjykata vëren se, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, ka mbështetur dhe vërtetuar të gjitha arsyetimet e Gjykatës Themelore dhe të Apelit, në lidhje me administrimin dhe interpretimin e provave, dhe zbatimin e të drejtës materiale. Gjykata vëren se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë marrë parasysh dhe vlerësuar nga gjykatat e rregullta, dhe rrjedhimisht, këto të fundit kanë ushtruar të drejtën e tyre në lidhje me

vlerësimin dhe interpretimin e rrethanave të rastit, dhe zbatimit të dispozitave procedurale dhe materiale.

43. Për me tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të argumentojë se në çfarë mënyre gjykatat e rregulla i kanë shkelur të drejtat e tij, cilat ligje materiale i kanë zbatuar në mënyrë “arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme”. Gjykata ritheksoni se ajo vetë nuk lëshohet në vlerësimin e provave, siç janë kontratat, ekspertizat dhe të tjerat, e as në përcaktimin e rëndësisë së tyre gjatë procesit gjyqësor. Gjykata nga citimit e mësipërme të gjykatave të rregullta, përfshirë edhe Gjykatën Supreme, vlerëson se vendimet e tyre përmbajnë arsye të mjaftueshme në lidhje me interpretimin e fakteve dhe vlerësimin të provave, që kanë çuar deri në një vendimmarrje të caktuar.
44. Gjykata nuk mund t'i kontestojë vlerësimet dhe interpretimet e këtyre të fundit, për sa kohë që ato nuk kanë cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, nuk janë arbitrare e as qartazi të paarsyeshme. Gjykata vlerëson se në dritën e rrethanave të rastit konkret interpretimet e fakteve dhe të provave nga gjykatat e rregullta, nuk kanë rezultuar në shkeljen e të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj.
45. Thënë këtë, Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin përfundimtar të procesit gjyqësor. Megjithatë, procesi i drejtë dhe i paanshëm gjyqësor nuk garanton rezultat të favorshme për parashtruesin. Në një kontest civil, njëra palë mund të humbas dhe tjetra të fitojë. Siç është elaboruar edhe më sipër, Gjykata nuk vepron si “shkallë e katërt” e sistemit të drejtësisë, por operon vetëm brenda juridiksionit të saj kushtetues, të përcaktuar nga Kushtetuta.
46. Andaj, nga të gjitha shtjellimet e mësipërme, Gjykata konsideron se pretendimet për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, përkitazi me interpretimin dhe vlerësimin e gabuar të fakteve dhe të provave, i përkasin kategorisë së parë (i) të pretendimeve që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”, andaj, si të tilla këto pretendime në baza kushtetuese deklarohen qartazi të pabazuara.

## **ii. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet e tjera**

47. Përveç pretendimeve të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i referohet edhe neneve 24 dhe 46 të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata përsërit se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së ose ndërlidhja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton vetvetiu edhe shkelje të neneve të tjera të Kushtetutës ose të KEDNj-së, nëse më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet në nivel kushtetutshmërie se si dhe përse ka ardhur deri të shkelja e tyre. Gjykata, vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; dhe së fundmi rastin [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
48. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 24 dhe 46 të Kushtetutës i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a) të pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara” andaj, si të tilla, në baza kushtetuese të njëjtat duhet shpallur qartazi të pabazuara.

## Përfundime

49. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: (I) pretendimet për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, përkitazi me interpretimin dhe vlerësimin e gabuar të fakteve dhe të provave, i përkasin kategorisë së parë (i) të pretendimeve që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”, andaj, si të tilla këto pretendime në baza kushtetuese deklarohen qartazi të pabazuara; (II) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës], të Kushtetutës, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese edhe këto pretendime shpallën qartazi të pabazuara.
50. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, në pajtueshmëri me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, duhet deklaruar e papranueshme si qartazi e pabazuar.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47.1 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 5 prill 2023, njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani